

VENDIM
Nr. 615, datë 2.10.2024

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E TARIFËS PËR KONSULENCËN
E OFRUAR NGA SUBJEKTI NDËRKOMBËTAR “*BOSTON CONSULTING GROUP*
(BCG)”, PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË KONSULENCËS PËR
IDENTIFIKIMIN E MEKANIZMAVE EFICIENTË PËR TË NXITUR MË TEJ
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE MUNDËSINË E PËRDORIMIT TË
INTELIGJENCËS ARTIFICIALE (IA) PËR KËTË QËLLIM, SI DHE PËR
PAGESËN E TARIFËS PËR KONSULENCËN E OFRUAR NGA SUBJEKTI
NDËRKOMBËTAR “*G37 CHAMBERS*”, PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË
KONSULENCËS PËR ANALIZIMIN DHE VLERËSIMIN E TË DHËNAVE, QË
DUHET TË MBLIDHEN NGA MINISTRIA E DREJTËSISË, ME QËLLIM
VLERËSIMIN E FUSHAVE TË REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN
KUNDËR KRIMINALITETIT DHE PËR HARTIMIN E METODOLOGJISË PËR
MËNYRËN E VLERËSIMIT E TË NDJEKJES NË VAZHDIMËSI TË ZBATIMIT
TË KËTYRE REKOMANDIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, shtohet fondi prej 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekësh, prej të cilave 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për pagimin e tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti ndërkombëtar “*Boston Consulting Group* (BCG)” për ofrimin e shërbimit të konsulencës për identifikimin e mekanizmave eficientë për të nxitur më tej luftën kundër korrupsionit dhe mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) për këtë qëllim, si dhe 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë për pagimin e kështit të parë të tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti ndërkombëtar “*G37 Chambers*”, për ofrimin e shërbimit të konsulencës për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave, që duhet të mblidhen nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim vlerësimin e fushave të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe për hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të këtyre rekomandimeve.

2. Efekti financiar, që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku